

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

L I G J

Nr. 10 484, datë 24.11.2011

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 040, DATË 22.12.2008
“KODI AJROR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 5, pas pikës 11 shtohen pikat 12, 13 dhe 14 me këtë përmbajtje:

“12. “Detyrim ndërkombëtar” është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar dhe në veçanti marrëveshja shumëpalëshe.

13. “Transportues ajror i huaj” është transportuesi ajror i vendeve të treta jashtë ZPAE-së.

14. “Shërbim ajror” është një fluturim ose një seri fluturimesh për transportim të pasagjerëve, ngarkesave dhe/ose postës për qëllime fitimi dhe/ose dhënies me qira.”.

Neni 2

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë VII. 7 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Licencimi dhe dhënia e lejeve bëhet sipas dispozitave në vijim të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.”.

Neni 3

Në nenin 7, në fjalinë e parë të pikës 2, fjalët “ndër të tjera” hiqen.

Neni 4

Në nenin 8, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. AAC është përgjegjëse për zbatimin e Kodit Ajror, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.”.

Neni 5

Në nenin 12, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Çdo person fizik dhe juridik nuk pajiset me licencë nëse nuk plotëson kërkesat për të mbajtur një licencë operative të vlefshme, të parashikuara në pikat 2 dhe 5 të nenit 13 të këtij Kodi, dhe nëse përfshihet në kategoritë e mëposhtme të shërbimeve ajrore:

- a) shërbime ajrore të kryera nga avionë pa ndezje motorike dhe/ose avionë me fuqi ultra të lehtë;
- b) fluturime lokale.”.

Neni 6

Në nenin 13 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Licenca e operimit është një autorizim i dhënë nga autoriteti kompetent licencues një sipërmarrjeje, duke lejuar që ajo të ofrojë shërbime ajrore të përcaktuara në licencën e operimit.”.

b) Në pikën 2, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) vendi kryesor i veprimtarisë është Republika e Shqipërisë;”.

c) Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

ç) pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Procedurat dhe kriteret për pajisjen me licencë operimi, si dhe vlefshmëria e tyre përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga ministri, në përputhje me detyrimet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.”.

Neni 7

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Transportues ajrorë të huaj

1. Transportuesit ajrorë të huaj duhet të zotërojnë leje operimi, të lëshuar nga AAC-ja, për të kryer transport ajror tregtar për në/nga Republika e Shqipërisë, përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare apo në marrëveshjet dypalëshe të transportit ajror.

2. Pajisja me leje operimi për transportuesit ajrorë të huaj bëhet në përputhje me rregullat për dhënien e lejes së operimit, të cilat përcaktohen me rregullore të miratuar nga ministri.”.

Neni 8

Në nenin 15 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Licenca e operimit refuzohet nga AAC-ja kur nuk plotësohen kërkesat e parashikuara në pikat 2 dhe 5 të nenit 13 të këtij Kodi, si dhe në rastet kur aplikuesi ka për qëllim të përdorë avionë jo të regjistruar në Republikën e Shqipërisë apo vendet anëtare të ZPAE-së, dhe kur avionët nuk janë marrë me qira, në përputhje me detyrimet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Licenca e operimit pezullohet ose hiqet nga AAC-ja, kur subjekti nuk i përmbush më kërkesat dhe detyrimet që duhen për lëshimin e licencës së operimit, që burojnë nga ky Kod dhe aktet e tjera nënligjore, të dala në zbatim të tij për këtë qëllim.”.

Neni 9

Në nenin 16, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Procedurat dhe kërkesat për pajisjen me COA përcaktohen me rregullore të vaçantë të ministrit përgjegjës për transportin ajror, siç përcaktohet në pikën “ç” të nenit 7 të këtij ligji.”.

Neni 10

Në nenin 40, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Operatori përcakton, për çdo avion, një listë minimale pajisjesh (LMP), e cila miratohet nga AAC-ja dhe është pjesë e dokumentacionit të parashikuar në nenin 39 të këtij Kodi. Sipas këtij Kodi, termi “LMP” nënkupton listën e pajisjeve të nevojshme që, në kushte të veçanta, mund të jenë jofunksionale, e përgatitur nga operatori, në përputhje me listën model të pajisjeve minimale, përcaktuar për llojin e avionit nga prodhuesi ose më të kufizuar se ajo.”.

Neni 11

Në nenin 59, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Sipas këtij Kodi, termi “aeroport me orare të rregulluara” nënkupton një aeroport ku ka mundësi për trafik të rënduar në disa periudha të ditës, javës ose vitit, të cilat mund të zgjidhen me bashkëpunim vullnetar ndërmjet transportuesve ajrorë dhe ku një rregullues i orareve është caktuar për të lehtësuar operimet e linjave ajrore që operojnë ose kanë për synim operimin e shërbimeve në atë aeroport.”.

Neni 12

Në nenin 64, pas fjalës “detyrimet” shtohen fjalët “ligjore kombëtare dhe”.

Neni 13

Në nenin 65, paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Me kërkesë të entit menaxhues të aeroportit dhe pasi është konsultuar me transportuesit ajrorë, Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit dhe palë të tjera të interesuara, AAC-ja mund të vendosë që në aeroport ose në një pjesë të aeroportit, disa përdoruesve të aeroportit t’u rezervohet e drejta për vetëpërpunim, ose që numri i ofruesve të shërbimeve të përpunimit në tokë për palët e treta të kufizohet. Kjo zbatohet vetëm për kategoritë e mëposhtme të shërbimeve të përpunimit në tokë, të cilësuara këtu si shërbime në zonën ajrore:”.

Neni 14

Në nenin 66, fjalia e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur në një aeroport shfaqen vështirësi për hapësirën dhe kapacitetin e disponueshëm, veçanërisht si rezultat i mbingarkesës dhe tejkalimit të normës së shfrytëzimit të zonës, të cilat e bëjnë të pamundur lirinë e tregut të shërbimeve ose zbatimin e vetëpërpunimit, në shkallën që parashikohet në këtë Kod, me kërkesë të entit menaxhues të aeroportit, dhe pasi është konsultuar me transportuesit ajrorë, Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit dhe palë të tjera të interesuara, AAC-ja vendos për:”.

Neni 15

Neni 67 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 67

Kërkesat

1. Çdo ofrues i shërbimeve të përpunimit në tokë duhet të provojë një gjendje të sigurt financiare.

2. Çdo ofrues i shërbimeve të përpunimit në tokë dhe çdo përdorues i aeroportit me vetëpërpunim duhet të përmbushë kërkesat në lidhje me:

- a) sigurinë;
- b) sigurinë e instalimeve, të pajisjeve të avionëve dhe të personave;
- c) mbrojtjen e mjedisit; dhe
- ç) duhet të vërtetojë një mbulim të mjaftueshëm siguracioni.”.

Neni 16

Neni 132 shfuqizohet.

Neni 17

Në nenin 137, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shumat minimale të mbulimit nga siguracioni, lidhur me përgjegjësinë ndaj palëve të treta, janë ato të parashikuara në nenin 119 të këtij Kodi, ndërsa për përgjegjësinë kontraktuale kjo shumë është 250 000 SDR për pasagjer.”

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)